



ZHVILLIMI I SHËRBIMEVE TË ORIENTIMIT NË KARRIERË DHE NDËRMARRËSISË PËR TË RINJ - INTERVENIM NË KUADËR TË PROJEKTIT PROCAREER 2

Udhëzues për mësuesin e fushës Jeta dhe Puna për zbatim të aktiviteteve
rreth edukimit dhe orientimit në karrierë në klasën e IX-të

PARATHËNIE

Ky udhëzues është hartuar në kuadër të projektit **ProCareer 2** dhe si rezultat i intervenimit *“Zhvillimi i shërbimeve të orientimit në karrierë dhe ndërmarrësisë për të rinj”* në komunat Pejë, Deçan, Klinë dhe Istog. Rrjedhimisht, ky udhëzues është përgatitur për mësimdhënësit e fushës Jeta dhe Puna që t’i mbështes ata në implementim të aktiviteteve që kanë të bëjnë me edukimin dhe orientimin në karrierë të nxënësve të klasave të IX-ta.

Përmes këtij intervenimi synohen të arrihen rreth 2,000 nxënës të klasës së IX-të dhe rreth 1,500 nxënës të klasës së XII-të nga shkollat e mesme të ulëta në komunën e Pejës, Deçanit, Klinës dhe Istogut. Ky intervenim u hartua me qëllim **(1)** të adresimit të mungesës së informatave tek nxënësit e klasës së IX-të rreth gjimnazeve dhe shkollave profesionaleve si dhe **(2)** zhvillimit të shkathtësive për vendimmarrje dhe planifikim të karrierës. Në këtë aspekt, ofrohet mbështetje dhe koordinim mes akterëve për aktivitete që mbështesin nxënësit në arritje të objektivave si **(1)** njohja e vetvetes, **(2)** eksplorimi i botës së profesionaleve, **(3)** njohja me drejtimet dhe shkollat e mesme të larta dhe **(4)** marrje dhe zbatim të një vendimi për karrierë.

Projekti po ashtu synon përfshirjen dhe angazhimin më të madh të prindërve, si faktor kyç në procesin e orientimit në karrierë të fëmijëve. Kjo do të mundësoj që edhe prindërit të jenë anëtarë aktiv të trekëndëshit mësimdhënës-prindër-nxënës.

Për më tepër, përmes këtij projekti synohet të adresohen sfidat e sistemit arsimor dhe ndërlidhje më e mirë me tregun e punës të këtij regjioni, duke arritur objektivat në vijim:

- ⦿ Ofrim i shërbimeve më të mira të këshillimit në karrierë në shkollë.
- ⦿ Vendim-marrja e bazuar në dëshmi e nxënësve të klasës së IX-të sa i përket karrierës së tyre dhe zgjedhjes së shkollës së mesme të lartë iu kalohet institucioneve lokale.
- ⦿ Vetëdijesim më i madh rreth punës vullnetare dhe kontribut më i lartë në komunitet nga nxënësit.
- ⦿ Bashkëpunim ndërmjet shkollave të mesme të ulëta dhe të larta të këtij regjioni në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe komunikim më i mirë rreth profileve të shkollave.
- ⦿ Informim i institucioneve politikë-bërëse duke zbatuar studim gjurmues me nxënësit e klasës së IX-të.
- ⦿ Sigurimi i qëndrueshmërisë së këtyre shërbimeve me bazë në shkollë.

Rrjedhimisht, intervenimi ka hapur dyert për zbatim të aktiviteteve të edukimit dhe orientimit në karrierë me nxënës të klasave të nënta nga vetë mësimdhënësit, me mbështetje nga drejtoria e shkollës dhe KCDF. Qëllimi i këtij doracaku është që të mbështesë mësimdhënësit pjesëmarrës në këtë intervenim dhe mësimdhënësit tjerë përgjegjës për Orientim në Karrierë.

MIRËNJOHJE

Një numër palësh të interesit kanë kontribuar në realizimin e këtij doracaku në kuadër të projektit. Për këtë arsye, për angazhimin e tyre, KCDF falënderon dhe shpreh mirënjohje për Drejtoritë Komunale të Arsimit në komunat përkatëse, drejtorët dhe mësuesit e shkollave të mesme të ulëta dhe shkollave të mesme të larta dhe prindërit për angazhimin në aktivitetet e parapara.

Për më tepër, mirënjohje të veçantë shprehim për organizatën ndërkombëtare Solidar Suisse në Kosovë, e cila ka mbështetur zhvillimin e projektit në aspektin financiar por edhe në konceptimin e këtij intervenimi me të gjitha shkollat e mesme të ulëta dhe shkollat e mesme të larta në komunat Pejë, Deçan, Klinë dhe Istog.

HYRJE

Ky udhëzues përmban aktivitete të ndryshme që kanë për qëllim mbështetjen e nxënësve në procesin e orientimit në karrierë. Këto aktivitete po ashtu janë të ndërlidhura edhe me ndërmarrësinë dhe TIK-un. Rrjedhimisht, aktivitetet janë të parapara të zbatohen në kuadër të fushës Jeta dhe Puna. Aktivitetet në fjalë përveç që zhvillojnë njohuritë dhe shkathësitë e nxënësve, ngritin kapacitetet e shkollës, promovojnë shkollat e mesme të larta, si dhe kontribuojnë në ndërlidhje të arsimit me treg të punës.


Për zbatimin e çdo aktiviteti është e rëndësishme të njoftohet KCDF, sepse në këtë mënyrë mund të ofrojmë mbështetje vazhdimisht gjatë zbatimit të aktiviteteve.

EDUKIMI DHE ORIENTIMI NË KARRIERË: AKTIVITETE PËR NXËNËSIT E KLASAVE TË IX-TA

Në vijim janë të shënuara një numër aktivitesh të parapara për zbatim me nxënësit e klasave të IX-ta në kuadër të fushës Jeta dhe Puna. Aktivitetet janë të ndërlidhura në atë mënyrë që të mbështesin zhvillimin e kompetencave të parapara dhe arritjen e rezultateve të të mësuarit, të parapara me kurrikulë.

Gjatë aktiviteteve, nxënësit inkurajohen që vazhdimisht të mbajnë një bllok për edukim dhe orientim në karrierë në të cilin mbajnë shënime. Këto shënime do t'iu shërbejnë atyre edhe për përpilim të **Planit Individual të Zhvillimit** në të cilin përpilojnë dhe përcjellin arritjen e objektivave për karrierën e tyre.

Për të lehtësuar leximin dhe të kuptuarit, aktivitetet e shënuara përmbajnë ikonat si në vijim:



Në fund të semestrit dhe vitit shkollor do të bëhet vlerësimi i zbatimit të aktiviteteve. Më shumë rreth këtyre aktiviteteve mund të gjeni në shtojcën 3. Shtojca 1 dhe 2 përmbajnë materiale mbështetëse për zbatim të aktiviteteve.

NJOHJA E VETVETES



Për të përzgjedhur karrierë të përshtatshme, nxënësit duhet të reflektojnë mbi tiparet e tyre të personalitetit, që konsiderohet hapi fillestar në procesin e orientimit në karrierë. Varësisht tipareve të personalitetit, nxënësit konsiderojnë profesionet dhe fushat e studimit që përputhen me karakterin e tyre.

Në vijim janë një numër i nën-aktiviteteve dhe udhëzimeve për mësimdhënës që mbështesin njohjen e nxënësve me vetveten.

Prezantimi i platformës Busulla.COM tek nxënësit dhe dhënia e instruksioneve për t'u regjistruar

Gjatë këtij hapi, nxënësve iu prezantohet në pika të shkurtra qëllimi i platformës [Busulla.COM](#) dhe moduleve. Udhëzoni nxënësit që të regjistrohen në [Busulla.COM](#) me kredencialet e tyre si: emri, mbiemri, klasa dhe shkolla.

Plotësimi i Testeve të Karrierës nga nxënësit dhe diskutimi i rezultateve

Gjatë dy orëve mësimore nxënësit udhëzohen që të plotësojnë [Testin IVAP](#) dhe [Testin e Potencialit](#) në [Busulla.COM](#). Plotësimi i përgjigjeve duhet të jetë relativisht i shpejtë dhe instinktiv në mënyrë që nxënësit të mos anojnë në përgjigjet e tyre. Para dhe pas plotësimit të testeve stimuloni diskutime të shkurtra, me pyetje të tilla si: Cilat janë interesat e juaja? Çfarë lloj aktivitete mendoni se i bëni më së miri? Më së shpejti? Për cilat aktivitete dhe lëndë mësimore pranoni më së shumti lëvdata? Çfarë është e rëndësishme për juve në punën tuaj?

Analizoni rezultatet e nxënësve, diskutoni dhe krahasoni ato me përgjigjet e nxënësve para plotësimit të testeve.

Udhëzimi i nxënësve që të diskutojnë pyetjet dhe rezultatet me prindër

Prindërit kanë ndikim në karrierën e fëmijës. Ata kanë njohuri të shumta për personalitetin dhe dëshirat e fëmijëve. Po ashtu, ata kanë edhe dëshira të tyre për fëmijët. Nxisni fëmijët që në shtëpi të diskutojnë me prindërit dëshirat dhe planet e tyre për të ardhmen.

Krijimi i fokus grupeve

Disa nxënës mund të ndajnë rezultate të njëjta. Kur të analizoni rezultatet, specifiku top profesionet e tyre krijoni fokus grupe që konsistojnë me nxënës me profesione të njëjta, apo të ngjashme. Këto fokus grupe do iu shërbejnë për aktivitetet e radhës. Takimet me profesionistë, vizitat në biznese, vizitat në shkolla të mesme të larta është e rëndësishme të bëhen varësisht këtyre fokus grupeve. Secili aktivitet është më efikas dhe më me interes për nxënësit kur është relevant për ta.

Prindërit po ashtu mund të plotësojnë **Testet e Karrierës** për fëmijën e tyre. Prindërit dhe nxënësit mund të krahasojnë dhe diskutojnë përgjigjet e njëri-tjetrit dhe rezultatet që iu janë shfaqur.

EKSPLORIMI I BOTËS SË PROFESIONEVE



Këto aktivitete iu mundësojnë nxënësve të marrin informata të shkruara rreth profesioneve si dhe informata të dorës së parë nga profesionistët mbi karrierën e tyre dhe të rrjetëzohen me ta. Po ashtu, të dëgjuarit e historive të personalizuara të karrierës dhe historive të suksesit motivojnë nxënësit për përzgjedhje dhe ushtrim të një profesioni.

Prezantimi i modulit “Profesionet” në Busulla.COM tek nxënësit

Gjatë një ore mësimore, prezantoni modulën “Profesionet” në **Busulla.COM**. Shpjegoni informatat në tekste të profesioneve, videot si dhe komponentët e këtij moduli si niveli i shkollimit, fusha e studimit, etj. Udhëzoni nxënësit që gjatë orës mësimore të informohen për profesionet e tyre të preferuara dhe të diskutojnë specifikat e këtyre profesioneve. Udhëzoni që në shtëpi të eksplorojnë profesionet e tjera që gjinden në këtë modul.

Organizimi i prezantimeve nga profesionistët

Bazuar në profesionet e preferuara të nxënësve dhe fokus grupet e krijuara, organizoni takime mes nxënësve dhe përfaqësuesve të këtyre profesioneve. Nxënësit, prindërit, ju dhe pjesa tjetër e stafit mund të identifikoni profesionistë të ndryshëm dhe t’i kontaktoni ata që të takohen me nxënësit. Takimet mund të organizohen në forma të ndryshme. Takimet mund të jenë virtuale, apo reale ku gjatë një ore mësimore profesionistët vizitojnë nxënësit në klasë dhe bisedojnë me ta. Profesionistët prezantojnë shtegun e tyre të karrierës, konkretisht shkollimin e tyre, punët që kanë bërë, kualifikimet e nevojshme dhe avancimin në karrierë. Ata po ashtu prezantojnë rreth profesionit të tyre, kërkesën për këtë profesion, detyrat e përditshme të punës, mjetet që përdorin, sfidat dhe mundësitë, paga, e të ngjashme.

Para takimeve, inkurajoni nxënësit që të përgatiten për këto takime, duke mbledhur informata rreth profesionit dhe duke bërë pyetje për profesionistët. Kështu, përpos prezantimit, profesionistët adresojnë edhe pyetjet e nxënësve.

Takimet me profesionistë mund të jenë edhe më efikase nëse organizohen në nivel shkolle. Kështu, disa profesionistë do të prezantonin në të njëjtën kohë, por në hapësira të ndryshme. Nxënësit do të njoftoheshin paraprakisht për të gjithë profesionistët që do të prezantojnë dhe do të ndjekin prezantimet që janë relevante për ta.

Organizimi dhe udhëheqja e vizitave të nxënësve në biznese

Përpos prezantimeve të profesionistëve, në mënyrë që nxënësit të kenë një ide sa më të qartë për të vendosur për profesionin e tyre, është e rëndësishme që të njoftohen edhe me vendet e punës të profesioneve të ndryshme. Identifikoni biznese që janë të gatshme që gjatë një ore të presin nxënësit dhe të iu prezantojnë aty vendin e punës atyre. Kështu, gjatë vizitës, nxënësit shohin vend-punimin, infrastrukturën, mjetet e nevojshme për punë, atmosferën dhe mënyrën e punës, e të tjera të ngjashme. Për organizim sa më efikas është e rëndësishme që me biznese të komunikohet qëllimi i vizitës, ndërsa nxënësve të iu komunikohet agenda. Po ashtu, është e rëndësishme që bizneset që nxënësit vizitojnë të përkohet me profesionet e tyre të preferuara.

Po ashtu, inkurajoni nxënësit që të marrin informata paraprake rreth vend-punimeve që do të vizitojnë, të përgatisin pyetje eventuale dhe të mbajnë shënime gjatë vizitës.

Ngjashëm me vizitat e profesionistëve, vizitat e nxënësve në biznese janë më efikase nëse organizohen në nivel shkolle. Rrjedhimisht, nxënësit e klasave të ndryshme, varësisht fokus grupeve, do të vizitonin bizneset me interes për ta. Për bashkëpunim afatgjatë, shkolla mund të nënshkruaj memorandum mirëkuptimi me bizneset, për vizita të vazhdueshme të nxënësve në bizneset e caktuara.

NJOHJA ME DREJTIMET DHE SHKOLLAT E MESME TË LARTA



Zgjedhja e një shkolle të mesme, duke reflektuar mbi profesionin në të ardhmen është qëllimi kryesor i këtyre aktiviteteve.

Arritja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me shkolla të mesme të larta është komponentë shumë e rëndësishme që ndihmon shkollat e mesme të ulëta të koordinojnë aktivitetet e tyre në bashkëpunim me

shkollat e mesme të larta. Në vijim janë paraqitur aktivitetet që mund të realizohen për t'i mbështetur nxënësit të përzgjedhin profilin që iu përshtatet. Për më tepër, shumica nga aktivitetet në vijim janë aktivitete të përbashkëta që nënkuptojnë arritjen e marrëveshjeve me shkollat e mesme të larta të regjionit.

Prezantimi i modulit “Shkollat/Universitetet” në Busulla.COM tek nxënësit

Gjatë një ore mësimore, prezantoni modulën “Shkollat / Universitetet” në [Busulla.COM](https://www.busulla.com). Shpjegoni përmbajtjen e këtij moduli dhe opsionet si: filtrimi përmes komunës, fushës së studimeve, krahasimi i profileve, ruajtja e profileve të preferuara, etj. Shpjegoni komponentin “Gjej shkollën / universitetin” që ndërlidh modulën e Profesioneve me Shkollat / Universitetet, si një mënyrë më e lehtë dhe shpejtë për të gjetur institucionet arsimore që ofrojnë drejtime/profile për profesionin e tyre të preferuar. Inkurajoni nxënësit të

njoftohen me syllabuset e profileve të preferuara, të krahasojnë ato dhe të analizojnë ndërlidhjen me profesione.

Organizimi i takimeve me Shkolla të Mesme të Larta

Pasi që janë pajisur me informata, është e rëndësishme që nxënësit po ashtu të takohen me përfaqësues nga shkollat e mesme të larta. Këta mund të jenë mësimdhënës, zyrtarë të Qendrave të Karrierës, përfaqësues të shkollës, apo edhe nxënës. Takimet mund të jenë virtuale apo përmes vizitave në shkolla. Kështu, nxënësit mund të adresojnë pyetjet shitesë që kanë dhe të mbledhin më shumë informata rreth pranimit në profilin e caktuar, plan programeve, aktiviteteve, etj. Po ashtu nxënësit njoftohen me infrastrukturën e shkollës. Si në aktivitetet paraprake, është e rëndësishme që takimet me përfaqësues të SHML dhe vizitat të organizohen varësisht fokus grupeve. Në këtë mënyrë, nxënësit vizitojnë vetëm profilet për të cilat kanë interes dhe të cilat përputhen me profesionet e tyre të preferuara.

Organizimi në nivel shkolle ndihmon në organizim më efikas. Ngjashëm si tek aktivitetet tjera, nxënësit e klasave të ndryshme bëhen bashkë që të vizitojnë shkollat relevante për ta.



Pjesëmarrja në ditën e dyerve të hapura


Dita e dyerve të hapura organizohet nga shkollat e mesme të larta si një aktivitet përmes të cilit nxënësit mund të informohen për së afërmi me zgjedhjet e mundshme për shkollim të mëtejshëm. Andaj, komunikoni me përfaqësues nga shkollat e mesme të larta për të kuptuar datën e realizimit të këtij aktiviteti. Njoftoni nxënësit për qëllimin dhe datën e pjesëmarrjes në këtë aktivitet dhe inkurajoni pjesëmarrjen e tyre.



Takimet virtuale me të diplomuarit (alumni) të shkollave të mesme të larta

Një formë tjetër e bashkëpunimit ndërmjet shkollës tuaj dhe një shkolle të mesme të lartë është edhe realizimi i takimeve virtuale me ish-nxënës të asaj shkolle. Për ta realizuar këtë aktivitet, kontaktoni me përfaqësues të një shkolle të mesme të lartë dhe kërkoni të dhënat kontaktuese të një nxënësi që ka vijuar mësimin në atë shkollë. Komunikoni me nxënësin dhe koordinohuni për datën dhe orën e realizimit të takimit virtual. Në këtë takim ftoni të gjithë nxënësit e interesuar të marrin pjesë për t'u informuar rreth përvojës së folësit/-es në shkollën e mesme të lartë ku ka vijuar mësimin dhe këshillat që mund t'iu jep atyre që janë të interesuar të vazhdojnë në atë shkollë.

TAKIMET ME PRINDËR DHE PLOTËSIMI I ANALIZËS SWOT DHE PLANIT INDIVIDUAL TË ZHVILLIMIT (PIZH)



Kontributi më i madh i prindërve në procesin e orientimit të fëmijëve të tyre në karrierë është nxitja dhe lehtësimi me kohë i kësaj bisede, dëgjimi aktiv dhe parashtrimi i pyetjeve të ndërlydhura me orientimin në karrierë. Prindërit mund të përfshihen më tepër në këtë proces duke mbajtur takime të rregullta dhe duke ndihmuar fëmijët në plotësimin e **Analizës SWOT** dhe **Planit Individual të Zhvillimit**. **Analiza SWOT** dhe **Plani Individual i Zhvillimit** janë mjete që ndihmojnë nxënësit në vlerësim, analizim, procesim dhe organizim të informatave. Po ashtu, përmes **SWOT** analizës dhe **PIZH** nxënësit zhvillojnë një qasje pro-aktive në vendimmarrje në karrierë, përmes identifikimit të pikave të forta, mundësive për zhvillim, përpilimit të objektivave dhe monitorimit të progresit në arritje të tyre.

Ligjërimi dhe dhënia e instruksioneve për plotësim të Analizës SWOT

Analiza SWOT ndihmon nxënësit në identifikim dhe vlerësim të pikave të forta dhe atyre për zhvillim të nxënësve dhe mjedisit të tyre. Ajo mund të përdoret për tipare të personalitetit, profesioneve, profileve të shkollave, etj. Gjatë një ore mësimore, udhëzoni nxënësit të plotësojnë SWOT analizën duke iu shtruar pyetje dhe diskutoni rezultatet dhe hapat e ardhshëm.

Prindërit po ashtu mund të plotësojnë Analizën SWOT për fëmijët e tyre dhe të krahasojnë e diskutojnë shënimet.

Ligjërimi dhe dhënia e instruksioneve për plotësim të Planit Individual të Zhvillimit

Gjatë një ore mësimore ligjëroni rreth përmbajtjes së PIZH. Udhëzoni nxënësit që të plotësojnë PIZH duke reflektuar mbi, dhe konsultuar, shënimet gjatë gjithë aktiviteteve paraprake. Konkretisht, Analizën SWOT, tiparet e tyre të personalitetit, informatat mbi profesionet dhe vend-punimet si dhe informatat rreth shkollave të mesme. Duke marrë parasysh gjithë këto informata, nxënësit planifikojnë, zbatojnë



Takimet me prindër

Ftoni prindërit në takime të rregullta me fëmijët e tyre dhe diskutoni rreth planeve të së ardhmes, planit individual të zhvillimit dhe hapat që fëmija duhet t'i ndërmarrë për të arritur objektivat e caktuara. Udhëzoni prindërit si t'i ndihmojnë fëmijët e tyre në plotësimin e Analizës SWOT dhe Planit Individual të Zhvillimit. Përveç kësaj, ftoni prindërit si mysafirë folës për ta prezantuar profesionin e tyre. Kështu, ju mund të bisedoni me prindër dhe të organizoni prezantime ku ngjashëm sikur takimet me profesionistë, ata tregojnë rreth një dite tipike në profesionin e tyre, shkollimi i nevojshëm, njohuritë që kërkohen e kështu me radhë.

dhe monitorojnë hapat e tyre të ardhshëm për vendimmarrje në karrierë dhe specifikisht pranimin në shkollën e mesme të lartë adekuate për profesionin e tyre të preferuar. Përcjellni punën e nxënësve në plotësim të PIZH, dhe udhëzoni ata që në vazhdimësi të vazhdojnë të punojnë në të dhe të përcjellin progresin në realizim të objektivave të tyre.

STUDIMI GJURMUES



Gjurmimi i tranzicionit të nxënësve nga klasa e IX-të në shkollë të mesme të lartë bëhet me qëllim për të kuptuar vendimet e tyre sa i përket vazhdimin të shkollimit të mesëm të lartë. Ky studim realizohet me qëllim për të analizuar nëse ekziston dhe cili është niveli i përputhjes në mes të fokus grupeve të krijuara, bazuar në testet e personalitetit dhe të potencialit dhe profileve të regjistruara nga nxënësit në shkollë të mesme të lartë.

Studimi gjurmues parashihet të ndodh çdo vit shkollor, gjatë muajve Tetor - Nëntor, me të gjithë nxënësit e klasave të IX-ta. Për realizimin e këtij studimi përdoret platforma [Busulla.COM](https://www.busulla.com) ku ofrohet mundësia për realizimin e pyetësorëve online.

Gjatë muajit Tetor krijoni një pyetësor në platformën [Busulla.COM](https://www.busulla.com) dhe shpërndajeni atë tek të gjithë nxënësit e klasës së IX-të të vitit shkollor paraprak. Në pyetësor përfshini pyetje që synojnë të kuptojnë vendimet e ndërmarra nga nxënësit pas përfundimit të klasës së IX-të në shkollën tuaj. Pyetje të tilla mund të jenë:

- A jeni regjistruar në shkollë të mesme?
- Nëse **JO**, pse nuk jeni regjistruar në shkollë të mesme?
- Nëse **PO**, në cilin drejtim dhe në cilën shkollë?

Po ashtu, mos harroni të përfshini pyetje rreth të dhënave personale ashtu që pastaj të kuptoni cilët nxënës janë regjistruar në cilën shkollë.

Pasi që nxënësit të jenë përgjigjur, analizoni dhe krahasoni përgjigjet e marra nga ta. Përpiloni një raport me të gjeturat e këtij studimi duke paraqitur vizualisht të dhënat. Në raport tregoni nëse ka nivel të përputhshmërisë ndërmjet profesioneve që ata i kanë deklaruar gjatë klasës së IX-të dhe profilit ku janë regjistruar në shkollë të mesme. Po ashtu, në raport mund të përfshini informata se sa është numri i nxënësve që nuk janë regjistruar fare në shkollë të mesme dhe arsytet pse nuk janë regjistruar. Për më tepër, në bazë të dhënave që i merrni mund t'i analizoni dhe të kuptoni nëse ka tendenca të ndonjëres prej gjinive për t'u regjistruar në profile të caktuara dhe të dhënat tjera interesante që mund të dalin nga kjo analizë.

Përmes këtij studimi ju do të informoni të gjitha palët e përfshira si nxënësit, prindërit, mësimdhënësit, shkollat dhe institucionet vendimmarrëse si drejtorinë komunale të arsimit, rreth gjendjes aktuale në shkollën tuaj dhe nevojave të nxënësve për drejtime të reja apo mbështetje në identifikimin e shtegut të duhur të karrierës.

PËRFUNDIM

Me realizim të suksesshëm të këtyre aktiviteteve do të kontribuojmë në nivel të nxënësit, shkollës dhe shoqërisë. Zgjedhja e një karriere që i përshtatet individit sjell kënaqësi dhe rrjedhimisht produktivitet në shkollë e në punë. Duke nxitur bashkëpunim me shkolla tjera, biznese, prindër, dhe duke zbatuar aktivitete të reja dhe relevante ndikojmë në rritje të cilësisë së shkollës. Gjersa duke promovuar mundësi të llojllojshme, si profesionet e ndryshme, shkollat profesionale, trajtojmë ndërlidhjen mes sistemit të arsimit dhe tregut të punës. Karriera mbulon rreth një të tretën e jetës sonë dhe kërkon marrje të disa vendimeve. Le të mbështesim nxënësit në fillimin e marrjes së vendimeve – zgjedhjen e shkollës së mesme të lartë të përshtatshme për ta.

Ekipi i KCDF-së është i gatshëm të ofrojë mbështetje, prandaj ju lutem në rast nevojë mos hezitoni të na kontaktoni!

Punë të mbarë dhe suksese!


SHTOJCA 1

ANALIZA SWOT

Analiza SWOT është një metodë që ndihmon në vlerësim të vetës dhe mjedisit përreth. Përmes Analizës SWOT mund të identifikoni atributet e juaja, dhe t'i krahasoni me specifikat e kërkuara nga një vend pune apo shkollimi. Pra në bazë të Analizës SWOT nxënësit kuptojnë pikat e tyre të forta dhe të dobëta në lidhje me kërkesat e profesionit të tyre të preferuar që synojnë ta kenë në të ardhmen.

Analiza SWOT është një matricë e ndarë në mes me një vijë vertikale dhe një horizontale. Në pjesën e sipërme janë dy faktorë të brendshëm, respektivisht pikat e forta dhe pikat e dobëta. Gjersa në dy pjesët e poshtme janë faktorët e jashtë, gjegjësisht, mundësitë dhe rreziqet. SWOT analiza bëhet për vetën, por edhe për të tjerët. Kështu për shembull, ju mund ta plotësoni për vetën tuaj, si dhe për shokun apo shoqen, dhe pastaj të analizoni, krahasoni e diskutoni përgjigjet.

Në vijim është paraqitur matrica e Analizës SWOT dhe në vijim disa sqarime dhe pyetje që iu ndihmojnë në plotësim të saj. Duke iu përgjigjur pyetjeve, plotësoni pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë për zhvillim dhe rreziqet eventuale, në hapësirat përkatëse.



Pikat e forta janë atributet pozitive që i posedon një individ dhe pikat promovuese të tij apo saj. Secili individ ka një masë të kontrollit në këto attribute. Për shembull këto mund të jenë:

- Tipare pozitive të personalitetit
- Shkathtësi relevante, kompetenca, njohuri dhe përvoja e punës
- Edukimi
- Rrjeti social
- Përkushtimi, entuziazmi, pasioni për fushën

Disa pyetje për që lehtësojnë identifikimin e pikave të forta janë:

- ⊙ Çka mund të bëj lehtë?
- ⊙ Çfarë mund të bëj më mirë se sa të tjerët?
- ⊙ Për çfarë marrë komente pozitive nga të tjerët?

Pikat e dobëta janë atributet negative. Fatmirësisht, kemi një masë kontrolli për të përmirësuar këto. E rëndësishme është identifikimi i tyre, në mënyrë që më vonë të përmirësohen. Attribute negative mund të jenë:

- ⊙ Karakteristika negative personale dhe shprehi të dobëta të punës
- ⊙ Mungesa e eksperiencës në përgjithësi, apo relevante
- ⊙ Mungesa e arsimimit
- ⊙ Mungesë të rrjetit social
- ⊙ Mungesë të një drejtimi në karrierë apo fokus
- ⊙ Shkathtësi të dobëta profesionale apo të menaxhimit të karrierës

Disa pyetje për që lehtësojnë identifikimin e pikave të dobëta janë:

- ⊙ Cilave detyra mundohet të iu shmangem? Cilat i bëj me vështirësi?
- ⊙ Në cilat situata i tregoj dobësitë e mia?
- ⊙ Çka do të dëshiroja të ndryshoja tek vetja?

Mundësitë janë ngjarje të jashtme, të pakontrollueshme, por që mund të i përdorim për avantazhin tonë. Për shembull:

- ⊙ Shërbimet e karrierës për të vizituar
- ⊙ Burimet në ueb me informata
- ⊙ Mbajtja e një praktike
- ⊙ Një vend pune i lirë
- ⊙ Trendët ekonomike
- ⊙ Një ngjarje për rrjetëzim
- ⊙ Kërkesa për shkathtësi të reja

Disa pyetje për që lehtësojnë identifikimin e mundësive janë:

- ⊙ Çfarë vlerësohet sot në fushën tuaj të ekspertizës?
- ⊙ Si mund të i zhvilloni më tej shkathtësitë tuaja?
- ⊙ Ku mund të drejtoheni për avancim?

Rreziqet janë faktorë të jashtëm të pakontrollueshëm që mund të veprojnë kundër jush dhe që kërkojnë ndërmarrjen e masave parandaluese. Për shembull:

- ⊙ Zhvillimi i teknologjisë për të cilën nuk jemi të përgatitur
- ⊙ Ndryshimi i kërkesave nga institucioni arsimor apo punëdhënësi
- ⊙ Konkurrenca
- ⊙ Standarde profesionale që nuk i arrini

Disa pyetje për që lehtësojnë identifikimin e rreziqeve janë:

- ⊙ A ka konkurrencë në rrugëtimin tuaj?
- ⊙ A keni burime të mjaftueshme për sukses?
- ⊙ Çfarë ndryshime e presin fushën tuaj?

Një faktor i jashtëm ndonjë herë mund të jetë edhe rrezik edhe mundësi. Për shembull, shfaqja e një gjuhe programimi që zëvendëson një gjuhë të cilën Vesa e ka të përvetësuar, mund të jetë kërcënim nëse ajo bëni asgjë në lidhje me këtë. Por, mund të jetë edhe nëse ajo angazhoheni të bëhet një nga ekspertët e hershëm.

Gjatë plotësimit të SWOT analizës është e rëndësishme që pikat e shkruara të jenë sa më specifike.

Pas shkrimit, analizoni çfarë kuptimi kanë gjërat e shkruara:

- ⊙ Vlerësoni pozitën tuaj të tanishme
- ⊙ Veçoni shkathtësitë, atributet dhe eksperiencat që duhet të i theksoni dhe ato që duhet të i minimizoni
- ⊙ Veçoni mundësitë që mund të i shfrytëzoni dhe rreziqet nga të cilat duhet të “mbroheni”

Vendosni se çfarë veprime mund të ndërmerri. Këto përfshijnë:

- ⊙ Të zhvilloni një shkathtësi
- ⊙ Të minimizoni apo të eliminoni një dobësi
- ⊙ Të shfrytëzoni një mundësi
- ⊙ Të mbron vetën nga rreziqet

SHTOJCA 2

PLANI INDIVIDUAL I ZHVILLIMIT

Plani individual i zhvillimit (PIZH) është një dokument që do të iu ndihmon gjatë procesit të vendimmarrjes në karrierë. PIZH ju ndihmon të identifikoni njohuritë dhe shkathtësitë që keni tani, planet për karrierë, dhe mënyrat se si do t'i realizoni këto plane. PIZH përmban shabllone të ndryshme, që iu ndihmojnë të reflektojnë mbi zgjedhjet dhe progresin në karrierë. Për të plotësuar PIZH, ju duhet të konsultoheni me shënimet që keni mbajtur në bllok gjatë aktiviteteve të ndryshme që kanë të bëjnë me karrierën. Por, ndryshe nga blloku ku keni mbajtur shënime, në PIZH duhet të tregoheni të përmbledhur dhe shumë specifik. Plani individual i zhvillimit është një përmbledhje prej 1-3 faqe dhe mund të ketë formate të ndryshme. Megjithatë, janë disa hapa dhe komponenta kryesore që PIZH duhet t'i përmbajë.

Hapi 1

Përpiloni një qëllim të përgjithshëm të Karrierës

Filloni Planin Individual të Zhvillimit duke treguar se cili është qëllimi apo qëllimet tuaja të karrierës. Kjo p.sh. mund të përfshijë dy apo tre profesionet që ju dëshironi të bëni, mënyrën e punësimit etj.

Hapi 2

Listoni interesat dhe shkathtësitë

Është e rëndësishme që Planin individual të zhvillimit ta plotësoni në të njëjtën kohë me hapat e zhvillimit të karrierës. P.sh. kur të përfundoni testet e karrierës dhe reflektoni mbi to dhe krijoni një listë në PIZH me rezultatet më të rëndësishme për juve.

Hapi 3

Listoni pikat e dobëta/për përmirësim, formuloni objektivat zhvillimore dhe aktivitetet përkatëse

Një komponentë kyçe e PIZH është pikat e dobëta. Këto pika të dobëta janë gjëra që ju duhet të l përmirësoni për të arritur qëllim tuaj të përgjithshëm. P.sh. një pikë e dobët mund të jetë niveli jo l kënaqshëm i gjuhës angleze. Plotësimi i SWOT analizës, dhe diskutimi i rezultateve me shokë e shoqe ju ndihmon shumë në plotësimin e kësaj komponente në PIZH. Pikat që ju keni shënuar për zhvillim, do të përkthehen pastaj në objektiva zhvillimore. P.sh. një objektivë zhvillimore do të ishte: Të marrë notë 5 në testin e fundit në gjuhën angleze. Për të vlerësuar progresin e arritjes së objektivave, duhet përdorur metoda SMART e formulimit. SMART është

akronim për: Specifike, të Matshme, të Arritshme, me Target kohor. Ju inkurajojmë të mësoni më shumë rreth objektivave SMART pasi që kështu e keni shumë më të lehtë të arrini qëllimet e juaja.

Përpos objektivave zhvillimore, duhet krijuar edhe një listë të aktiviteteve që do të iu ndihmojnë të arrini këto objektiva. P.sh. nëse objektivë e juaja është të merrni notën pesë në gjuhë angleze, si do ta bëni këtë? Çfarë veprime duhet të ndërmerri që të arrini këtë? Disa mënyra do të ishin: duke qenë aktiv në klasë, duke bërë çdo detyrë shtëpie, duke bërë detyra shtesë në internet, apo duke vijuar ndonjë kurs të gjuhës angleze.

Hapi 4

Implementoni planin tuaj individual të karrierës dhe raportoni progresin

Pasi të keni shënuar gjithë këto pika të rëndësishme, është koha për veprim! Tani, ju duhet të bëni të gjërat që i keni planifikuar për vetën tuaj. Kur jeni duke implementuar Planin tuaj të zhvillimit, sigurohuni ta mbani afër atë dhe të mbani evidencë të progresit. P.sh. raportoni si të

mbaruara gjitha veprimet që i keni bërë apo objektivat që i keni arritur. Në shtojcë është i bashkëngjitur një format i Planit Individual të Zhvillimit. Po ashtu, mund të gjeni edhe një formë të plotësuar për ta përdorur si shembull.

EMRI:	DATA:
QËLLIMET PROFESIONALE	
Cilat janë dëshirat e mia profesionale? Çfarë karriere dua?	

INTERESAT DHE AFTËSITË (3-5)		PIKAT E DOBËTA / MUNDËSITË PËR ZHVILLIM (3-5)
Cilat janë interesat e mia profesionale?	Cilat janë aftësitë e mia profesionale?	Cilat janë pikat e mia të dobëta që duhet t'i përmirësoj në mënyrë që të arrij qëllimet e mia?

OBJEKTIVAT ZHVILLIMORE	AKTIVITETET	MATJA E SUKSESIT	DATA	VLERËSIMI
Cilat objektiva planifikoni t'i arrini?	Cilat aktivitete ju ndihmojnë ta arrini objektivën?	Cilët janë treguesit që keni arritur objektivën?	Kur është afati kohor i arritjes së objektivave?	Nga 1-5, sa e vlerësoni që keni arritur objektivën?

EMRI:	Gent	DATA:	02.03.2021
--------------	-------------	--------------	-------------------

QËLLIMET PROFESIONALE

Cilat janë dëshirat e mia profesionale? Çfarë karriere dua?

Pasi të përfundoj fakultetin për arkitekturë, dua të ushroj profesionin e arkitektit. Në fillim, dua të punësohem në ndonjë biznes të mirë. Por më tutje, pasi të kem fituar përvojë, dua të hap firmën time.

INTERESAT DHE AFTËSITË (3-5)		PIKAT E DOBËTA / MUNDËSITË PËR ZHVILLIM (3-5)
Cilat janë interesat e mia profesionale?	Cilat janë aftësitë e mia profesionale?	Cilat janë pikat e mia të dobëta që duhet t'i përmirësoj në mënyrë që të arrij qëllimet e mia?

- ⊙ Të vizatoj skica
- ⊙ Të filloj biznesin tim
- ⊙ Të bisedoj me të tjerët
- ⊙ Të punoj në zyrë por edhe në terren

- ⊙ I vëmendshëm ndaj detajeve
- ⊙ Zgjidhja e detyrave matematikore
- ⊙ Orientimi në hapësirë

- ⊙ Menaxhim jo të mirë të kohës
- ⊙ Nota jo shumë të mira në fizikë

OBJEKTIVAT ZHVILLIMORE	AKTIVITETET	MATJA E SUKSESIT	DATA	VLERËSIMI
Cilat objektiva planifikoni t'i arrini?	Cilat aktivitete ju ndihmojnë ta arrini objektivën?	Cilët janë treguesit që keni arritur objektivën?	Kur është afati kohor i arritjes së objektivave?	Nga 1-5, sa e vlerësoni që keni arritur objektivën?

Të përmirësoj shkathtësitë në menaxhim të kohës

- ⊙ Të hulumtoj se si duhet menaxhuar koha
- ⊙ Të bëj një plan të punës
- ⊙ Të limitoj kohën në rrjete sociale në 1 orë në ditë

- ⊙ Materialet e konsultuara
- ⊙ Plani i punës
- ⊙ Koha e kaluar në rrjete sociale

Prill 2020

4

Të kem notën përfundimtare 4 në lëndën e fizikës

- ⊙ Të jem aktiv në orën e mësimit
- ⊙ Të mësoj nga 2 orë dhe 30 minuta para çdo ore të mësimit
- ⊙ Të bëj të gjitha detyrat e shtëpisë
- ⊙ Të mësoj për provime

- ⊙ Aktiviteti në klasë
- ⊙ Detyrat e shtëpisë
- ⊙ Orët e kaluara në total duke mësuar
- ⊙ Notat përfundimtare

Maj 2020

5

SHTOJCA 3

MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ORIENTIMIT NË KARRIERË

Si mësues të fushës Jeta dhe Puna po ashtu do të vlerësoni zbatimin e aktiviteteve të Orientimit në Karrierë. Qëllimi i këtij vlerësimi është intervenimet eventuale për zbatim të suksesshëm të aktiviteteve dhe arritje të objektivave.

Raportimi mund të bëhet:

- ⦿ Online, duke klikuar në link-un në vijim: [Forma e vlerësimit](#)
- ⦿ Përmes Formës së vlerësimit të ofruar më poshtë.

Forma e vlerësimit përmban rreth 10 pyetje për aktivitetet e zbatuara dhe ndikimit të tyre, sfidave dhe rekomandimet. Përgjigjet në pyetje do të jenë të qasshme për drejtorin e shkollës suaj, DKA-në dhe palët mbështetëse të projektit. Duke qenë se jeni ju ata që do të zbatoni aktivitetet me nxënës, përgjigjet e juaja na ndihmojnë që të kuptojmë më mirë procesin në klasë. Në rast nevojë, aktivitet do të adaptohen për të mbështetur arritjen e objektivave.

Forma e vlerësimit do të plotësohet dy herë gjatë vitit, si në vijim:

- ⦿ Dhjetor (brenda periudhës 10 – 20 dhjetor) – Për semestrin e parë
- ⦿ Qershor (brenda periudhës 10 – 20 qershor) – Për gjithë vitin shkollor.

Emri dhe mbiemri

Shkolla

A jeni mësimdhënës/-e i/e fushës Jeta dhe puna? Po Jo

A jeni i/e trajnuar për Orientim për Karrierë? Po Jo

Çfarë trajnimi keni mbajtur?

A e keni implementuar Orientimin në Karrierë? Po Jo

Sa orë Orientim në Karrierë keni ligjruar?

Cilat aktivitete rreth Orientimit në Karrierë i keni zbatuar me nxënës?

Cilat aktivitete rreth Orientimit në Karrierë i keni zbatuar në bashkëpunim me prindër?

Cilat aktivitete rreth Orientimit në Karrierë i keni zbatuar në bashkëpunim me bizneset?

Ju lutem tregoni sa pajtoheni me deklaratën në vijim: Aspak Pak Mesatarisht Mjaft Shumë

Rezultatet e të nxënësve për komponentën e Orientimit në Karrierë gjatë kësaj periudhe janë arritur me sukses.

Çfarë vështirësi apo sfida keni hasur në ligjërimin e Orientimit në Karrierë?

Çfarë do të dëshironit të ndryshoni për t'ua lehtësuar ligjërimin e Orientimit në Karrierë në të ardhmen?

